

(Albanese)

VIKTIMË: CFARË DUHET BËRË

A keni pësue një agresion, një krim kundër integritetit tuaj?

Këshilla të nevojshme se si të procedohet:

Mbrojtje

- Kërko intervenimin e Policis;
- Siguro vetëveten (ndërrimin eventual të bravës së derës, i shoqëruar gjate qdo lëvizje, mbrenda nates qëndro në një shtëpi të mbrojtur për gra, etj);
- Kërko ndihmë nga miqtë apo të njohurit;
- Denonco faktet: ankëse penale ose padi.

Kujdes mjekësor

- Konsulto sa më par të jetë e mundur nje mjek (urgjencën në spital apo mjekun privat) për të marrë mjekimin e nevojshëm dhe të vërtetojë dhunën: shenjat fizike mund të zhduken pas pak ditë!
- Certifikata mjekësore mund të jet një provë vendimtare për çdo procedurë ligjore.

Si të kërkohet ndihmë

- Kontaktoni Shërbimin LAV detajet e kontaktit furnizohen nga Policia;
- E rëndësishme është të mos jeni vetëm me vuajtjet tuaja, por bisedoni për këtë me dikënd të besueshëm, apo me një profesionist, planifikoni hapat tjer pas agresionit (vendebanimi, masat e sigurisë për veten dhe fëmijët, aspektet financiare dhe ligjore, vlerësimi i mundësis për të paraqitur një ankesë).

Vlerësimi i provave

- Sigurohuni që certifikata mjekësore përmend me hollësi dëmtimin fizik dhe gjendjen psikik;
- Ruajë dhe mos bëj larjen e rrobave të veshur gjatë sulmit (fizik apo seksual), si dhe çdo gjurmë të mbetur në trupin tuaj (mos laj trupin);
- Lëri shenjat në vend dhe në objekte ku ndodhi sulmi;
- Ruajë mesazhet (sms, e-mail, regjistrime, etj.)
- Sheno identitetin e dëshmitarëve eventual.